



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Dhjetor, 2025

**PËRMBAJTJA E
BULETINIT**

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit dhjetor 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

**1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT DHJETOR
2025**

Gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar 21,192 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(1,189.14 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (18,865 raste apo Inc 1,058.57 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Influenca sezonale (ILI) me 15,234 raste ose Inc. 854.83/100,000, Diare ac. me 3,072 raste ose Inc. 172.38/100,000 banorë dhe ARI/ITPR me 1,880 raste ose 105.49 në 100,000 banorë (Tab.1).

Gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar 8 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me dg. Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse, 3 raste me dg. Meningoencephalitis acuta me diagnozë përcjellëse, 1 rast me Influençë A me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me AIDS.

Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuara në Kosovë, dhjetor 2025 krahasuar me dhjetor 2024

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuara në Kosovë				
01 - 31 dhjetor të vitit 2025 dhe 2024				
Sëmundjet/shkaktarët	Dhjetor, 2024		Dhjetor, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	3	0.17	2	0.11
ITPR - Pneumonia/ARI	1869	104.88	1880	105.49
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	23	1.29	45	2.53
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	12058	676.61	15234	854.83
Influenca A	78	4.38	219	12.29
Influenca B	7	0.39		0.00
RSV	37	2.08	87	4.88
Diarea acute	4157	233.26	3072	172.38
Variçela	478	26.82	456	25.59
Sindromi meningjeal	14	0.79	8	0.45
Helmimet me ushqim	8	0.45	53	2.97
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	13	0.73	2	0.11
Salmonella enteritidis	2	0.11		0.00
Gastroenterokolitet	50	2.81		0.00
Hepatiti akut B	1	0.06	27	1.52
Hepatiti akut C		0.00		0.00
Parotitits	3	0.17	2	0.11
Pertussis	4	0.22	2	0.11
Tularemia	1	0.06	1	0.06
Brucellosis	9	0.51		0.00
Sëmundja Lyme	1	0.06		0.00
Toxoplazmozë		0.00	1	0.06
HIV/AIDS	3	0.17	5	0.28
IST	12	0.67	28	1.57
TB	5	0.28	41	2.30
Giardiaza		0.00	6	0.34
Cl.difficile	1	0.06		0.00
Infeksionet streptokoksike të grupit A	5	0.28		0.00
Mpox**	1	0.06		0.00
*Sëmundjet tjera ngjitëse	22	1.23	21	1.18
Gjithsej	18865	1058.57	21192	1189.15
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				
** Raste të importuara-Mpox				

1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, DHJETOR 2025

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit dhjetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 15,234 raste me ILI (Inc. 854.83/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rritje prej 26.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (12,058 raste) dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, nëntor 2025 me (6,336 raste të raportuara me ILI) rritje eksponenciale. Kjo rritje mund t'i atribuohet disa faktorëve si qarkullimin e shtuar të viruseve respiratore, përfshirë virusin e gripit dhe viruset e tjera respiratore, uljen sezonale të temperaturave, rritjen e qëndrimit në ambiente të mbyllura dhe shtimin e kontakteve ndërpersonale gjatë kësaj periudhe.

Diarea akute: Gjatë muajit dhjetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 3,072 raste me diare akute (Inc.172.38/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,157 raste), vërehet një ulje prej 26.1% dhe gjithashtu krahasuar me muajin nëntor 2025, me 3,894 raste të raportuara, ulje prej 21.1% e rasteve të raportuara. Megjithatë, pavarësisht rënies, numri i rasteve të raportuara mbetet shqetësues për shëndetin publik, marrë prasysh ekspozimin e vazhdueshëm të popullatës ndaj patogjenëve të ndryshëm ushqimorë dhe atyre përmes ujit, veçanërisht kushtet e ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

ARI/ITPR: Gjatë muajit nëntor 2025 në IKSHPK janë raportuar 1,880 raste me ARI (Inc.105.49/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,869 raste) vërehet numër afërsisht i njëjtë i rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak nëntor 2025 me (1,450 raste), rritje prej 29.65%. Kjo rritje lidhet kryesisht me fillimin e sezonit të infeksioneve respiratore, uljen e temperaturave, si dhe rritjen e ekspozimit në ambiente të mbyllura, duke favorizuar përhapjen e patogjenëve respiratorë. 1,450

Variçella: Gjatë muajit dhjetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 456 raste me Variçellë (Inc.25.59/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (478 raste) vërehet ulje prej 4.6% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak nëntor 2025 me 537 raste të raportuara, ulje prej 15.08% e numrit të rasteve të raportuara.

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit dhjetor 2025, në laboratorin e Mikrobiologjisë- IKShPK nga të gjitha mostrat e testuara si të dyshimta në fruth, parotit, pertussis dhe rubellë janë konfirmuar 2 raste pozitive me Pertussis. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë raportuar edhe 2 raste me Parotit (raste të dyshimta). Rastet e konfirmuara me Pertussis, sipas komunave: Prishtinë (2 raste) . Sipas grup-moshës rastet i takojnë, grupmosha 5-9 vjeç (1 rast) dhe mbi 20 vjet (1 rast). Të dy rastet pozitive kanë status vaksinal të kompletuar për moshën. Gjatë këtij muaji janë konfirmuar edhe dy raste pozitive me parotit. Shpërndarja sipas komunave është: Prishtinë dhe Dragash me nga 1 rast. Sipas grup-moshës: grup-mosha 10-15 vjeç (1 rast) dhe mbi 20 vjeç (1 rast). Të dy rastet kanë status vaksinal të kompletuar për moshën.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë muajit dhjetor 2025, nga mostrat e testuara, është konfirmuar 1 rast për Tularemi dhe 1 rast me Toksoplazmozë.

Rasti pozitiv me Tularemi është regjistruar nga komuna e Lipjanit, i përket gjinisë mashkullore dhe i takon grupmoshës 30–39 vjeç. Sipas anketës epidemiologjike, rasti jeton në një shtëpi dy-katëshe, me kushte të mira banimi.

Pas anketimit, u konstatua ruajtja jo e duhur e ushqimeve në depo dhe mungesa e mbrojtjes ndaj brejtësve dhe insekteve, si dhe kushte të pasigurta për furnizimin me ujë. Rreziku i kontaminimit biologjik ishte i lartë për shkak të këtyre faktorëve.

Rasti pozitiv me Toxoplazmozë është raportuar nga komunën e Pejës, i përket gjinisë femërore dhe i takon grupmoshës 20–29 vjeç. pa shenja klinike apo simptoma. Ajo ka kryer analiza rutinore laboratorike, për shkak se është shtatzënë në javën e 7-të të gestacionit, ku rezultatet serologjike kanë treguar IgG dhe IgM pozitive për Toxoplasma gondii.

Sipas anketës epidemiologjike, rasti deklaroi se në shtëpinë e prindërve kanë një qen dhe një mace, megjithatë ajo mohon të ketë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me këto kafshë. Nuk janë identifikuar faktorë të tjerë të qartë rreziku gjatë anketimit epidemiologjik lidhur me rrugët e transmetimit të toksoplazmozës, masat parandaluese gjatë shtatzënisë si dhe rëndësinë e ndjekjes së rregullt mjekësore.

Sindroma meningjeale

Gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar gjithsej 8 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.45/100,000 banorë), prej tyre 7 raste me Meningjit Acuta, dhe 1 rast me Meningjit Acuta Serosa. Numri i rasteve të raportuara është më i ulët krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak (dhjetor, 2024), kur ishin raportuar 14 raste (Inc. 0.78/100,000 banorë). Sipas komunave, numri më i madh i rasteve është raportuar në Pejë dhe Fushë-Kosovë me nga (3 raste), ndërsa me nga 1 (një) rast janë raportuar në komunat Ferizaj dhe Lipjan.

Sa i përket grup-moshës, gjatë kësaj periudhe, grup-mosha më e prekur është 0–9 vjeç, me 7 raste (87.5%), ndërsa 1 rast (12.5%) i takon grup-moshës 70–79 vjeç.

Sipas gjinisë, 75.0% (6 raste) i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 25.0% (2 raste) i takojnë gjinisë femërore.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK përmes sistemit MedLis, dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 3 shkaktarë viralë në LCS, prej tyre 1 rast me Human Herpes Virus 6 (HHV-6) dhe 2 raste me Human Herpes Virus 7 (HHV-7).

Nga rastet e raportuara gjatë muajit dhjetor 2025, tri raste kanë përfunduar me vdekje, dy raste të gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore. Rastet janë nga komuna e Gjilanit, Ferizajit dhe Deçanit.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit dhjetor 2025, përmes SMSN nga të gjitha regionet janë raportuar gjithsej 611 raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: 569 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (A09); 12 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (A04.8) ; 22 raste me dg. Intoksikacionet tjera bakteriale alimentare - A05; 3 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (A04.9)

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar 2 raste me Rotavirus dhe 1 me Giardiazë. Rastet pozitive në Rotavirus sipas komunave janë: 1 rast në komunën e Ferizait dhe 1 rast nga Vitia. Sipas grup moshave të dy rastet i përkasin grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë njëri rast është i gjinisë femërore dhe tjetri i gjinisë mashkullore.

Rasti pozitiv me Giardiazë, i përket gjinisë femërore, grupmoshës 0-9 vjeç dhe është nga komuna e Fushë Kosovës.

Të trija këto raste ishin të hospitalizuara në klinikën infektive me simptome gjeneralë të inflamacionit dhe me simptoma gastrointestinale specifike. Pas anketimit përmes anketës epidemiologjike të rastëve dhe prindërve të tyre, u dhanë rekomandimet e nevojshme për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të infeksioneve, me theks të veçantë në përmirësimin e higjienës personale, larjen e rregullt të duarve me sapun, përdorimin e ujit të pijshëm të sigurt, përgatitjen higjienike të ushqimit, dezinfektimin e rregullt të ambienteve dhe lodrave, si dhe shmangien e kontaktit të fëmijëve të shëndetshëm me rastet e sëmura. Gjithashtu, u theksua rëndësia e respektimit të kalendarit të rregullt të vaksinimit dhe njoftimit në kohë të shërbimeve shëndetësore në rast të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit dhjetor 2025, janë testuar gjithsej 590 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel.

Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 219 raste me Influcencë A dhe B apo pozitivitet prej 34.8%. Sipas tipit: Të gjitha rastet pozitive janë me Influcencë A (219 raste apo 37.1%).

Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 87 (14.7%) mostra pozitive me RSV, 78 (13.2%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 43 (7.3%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 8 (1.36%) mostra pozitive në Parainfluenca Virus dhe 3 (0.5%) mostra pozitive në Metapneumovirus. *(Grafikoni 1)*

Nga 219 raste të raportuara/konfirmuara me Influcencë A, 20 apo 9.1 % e tyre janë vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal, kryesisht moshë e shtyer (65+).

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2025/2026 si dhe Buletinën javor për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike.

Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për muajin dhjetor 2025 paraqitet në aktivitetin e lartë të qarkullimit dhe krahasuar me muajin paraprak shënon rritje të numrit të rasteve të raportuara. Modeli i përhapjes tregon përhapje të gjerë, me shtrirje në komuna dhe rajone të ndryshme, që paraqet fazën aktive të qarkullimit sezonal të virusit të Influcencës A.

Gjatë muajit dhjetor 2025, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) dhe qendrave sentinel u raportuan gjithsej 45 raste me SARI (Inc.2.5/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (23 raste) vërehet rritje e numrit të rasteve për 95.6% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (25 raste), vërehet një rritje prej 80% e numrit të rasteve. Të gjitha rastet sipas protokollit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan, 21 mostra pozitive në Influcencë A, 3 mostra pozitive në Virusin Sincial (RSV), 2 mostra pozitive në Human Adenovirus dhe 2 mostra pozitive në Human Rhinovirus.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (22 raste), Vushtrri (4 raste), Podujevë (3 raste), Fushë Kosovë (2 raste), Klinë (2 raste), Deçan (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Drenas, Gjakovë, Lipjan, Malishevë, Novobërdë, Mitrovicë, Istog, Viti, Gjilan dhe Hani i Elezit. (Tabela 1)

Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (14 raste), 0-4 vjeç (13 raste), 51-64 vjeç (10 raste), 15-34 (4 raste), dhe 35-50 vjeç (4 raste). Sipas gjinisë, 27 prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe 18 gjinisë mashkullore.

Në SMSN, gjatë muajit dhjetor 2025, janë raportuar 41 raste me Tuberkuloz apo 2.3 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (8 raste), Malishevë (6 raste), Prizren (5 raste), me nga (3 raste) komunat: Fushë Kosovë, Istog dhe Suharekë, me nga (2 raste) komunat: Pejë, Ferizaj dhe Shtime, kurse komunat si: Gjilan, Podujevë, Glogoc, Kamenicë, Obiliq, Kaçanik dhe Rahovec me nga (1 rast). Prej 41 rasteve të raportuara, 28 (68.2%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 13 (31.7%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 15 raste (53.5%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojnë se grup- mosha më e prekur është ajo 50-59 vjeç (13 raste), 70-79 vjeç (7 raste), grupmoshat: 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç me nga (6 raste), 60-69 vjeç (5 raste), 30-39 vjeç (2 raste), kurse grup moshat 0-5 vjeç dhe 15-19 vjeç me nga 1 rast, si dhe grupmosha 10-14 vjeç asnjë rast. Sipas gjinisë, rezultojnë se gjinia mashkullore me 53.6% (22 raste) kurse 46.3% (19 raste) i takojnë gjinisë femërore.

Rastet me HIV/AIDS/IST

Gjatë muajit dhjetor 2025, janë raportuar 5 raste me HIV/AIDS dhe një rast i vdekjes si pasojë e AIDS-it (rasti i vdekjes është nga komuna e Prishtinës dhe i takon grup moshës 45-54 vjeç). Të gjitha rastet janë të gjinisë mashkullore. Rastet janë nga komunat: Gjilan, Prishtinë, Preshevë, Fushë Kosovë dhe Pejë.

Dy raste rrugën e transimisionit e kanë heteroseksuale, dy i takojnë komunitetit MSM dhe për një rast rruga e transimisionit është akoma e panjohur. Një rast i takon grup moshës 15-24 vjeç, tri raste grup moshës 35-44 vjeç dhe një rast asaj 45-54 vjeç.

Raportimi me SMSN: Të gjitha rastet janë raportuar përmes MedLis nga mikrobiologjia. Në SMSN janë raportuar 3 raste

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), dhjetor 2025

Gjatë muajit dhjetor 2025 janë raportuar gjithsej 28 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 9 raste, Pejë 8 raste, Prishtinë 3 raste, Klinë 2 raste, Rahovec 1 rast, Deçan 1 rast, Fushë Kosovë 1 rast, Kaçanik 1 rast, Vushtrri 1 rast, Suharekë 1 rast. Sipas diagnozës: Chlamydia 10 raste, Condyloma 13 raste, Gonorrhoeae 3 raste dhe Sifilis 2 raste.

Sipas gjinisë: 16 (57%) i takojnë gjinisë femërore dhe 12 (43%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 25-49 vjeç 15 raste (54%), 15-24 vjeç 12 raste (43%), dhe një rast mbi 50 vjeç (3%).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C

Gjatë muajit dhjetor, nuk është raportuar asnjë rast me Hepatit akut B dhe Hepatit akut C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, dhjetor 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave Dhjetor 2025																							
SËMUNDJA	Pneumonia/ ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Varicella	Influenca A	RSV	COVID- 19	Sindroma meningjeale		Parotitis epidemic a	Pertussis	Helmime t me ushqim	Gastroen terokolit et	Tularemi	Rotaviru s	Toxoplaz moza	IST	HIV	TB	Giardiaz a	Sëm.tjera ngjitëse	Totali
									Meningjit acuta	Meningjiti s ac. Serosa													
DEÇAN	30	2	280	36	9			1										1					359
DRAGASH	4		92	19						1													116
DRENAS	6	1	122	19	5	5	1													1			160
F. KOSOVË	1	2	415	63	13	13	11		2	1			1	1			1	1	3	1			529
FERIZAJ	64		422	131	8	7	6	1	1				2	3		1		9		2	2		659
GJAKOVË	4	1	320	35	25	3	1																389
GJILAN	27	1	763	174	7	4	1												1	1			979
GRAÇANICË																							0
H. I ELEZIT	1	1	109	18	2			2															133
ISTOG	13	1	209	26																3			252
JUNIK	2		27	2	2																		33
KAÇANIK	4		65	25	3	2	1											1		1			102
KAMENICË			493	84																1			578
KLINË	56	2	172	41	11	1	1											2					286
KLLOKOT																							0
LEPOSAVIQ																							0
LIPJAN		1	62	10		6	2		1						1								83
MALISHEVË	0	1	98	17	5	10	3						1	3						6			144
MAMUSHË	1		98	26	3																		128
MITROVICË	100	1	2036	370	38	47	2							1								15	2610
MITROVICË E VERIUT																							0
N. BËRDË		1	31	17		1	1																51
OBILIQ			237	15	12	1	1														1		267
PARTESH																							0
PEJË	48		1290	218	29	3	1		3				15				1	8	1	2			1619
PODUJEVË	5	3	148	66	8	8	7														1		246
PRISHTINË	1453	22	4574	884	174	91	40	1		1	2	26	16				3	1	8		2		7298
PRIZREN	28		982	409	64	1	1					5							5	1	4		1500
RAHOVEC	3	0	225	15		2												1		1	2		249
RANILUG																							0
SHTËRPCE																							0
SHTIME	22		602	64	1		2							1						2			694
SKËNDERAJ	2		159	56	9	2																	228
SUHAREKË	5		830	163	18	3	1											1		3			1024
VITI		1	197	50	5	1	1							1		1							257
VUSHTRRI	1	4	176	19	5	8						3	1					1					218
Z. POTOK																							0
ZVEÇAN																							0
BURGU I LIPJANIT																							0
PA ADRESË																			1				1
TOTALI	1880	45	15234	3072	456	219	87	2	7	1	2	2	53	27	1	2	1	28	5	41	6	21	21192

*Sëmudjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, DHJETOR 2025

Rastet e spitalizuara në numër më të madh nga sëmundjet ngjitëse janë raportuar nga pneumonitë dhe infeksionet virale të traktit respirator, të pasuara me diarë akute dhe gastroenterokolite. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa pjesa tjetër raportohet bazuar në diagnozën klinike (shih Tabela 3).

Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatrië dhe spitalet e përgjithshme, dhjetor 2025

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	252
SARI	45
Sindroma meningjeale	8
Helmimet me ushqim	14
Diarea akute dhe gastroenterocolite	110
Status febrilis	10
Mononucleosis	1
Erysipela	4
Herpes Zoster	1
Total	445

4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT DHJETOR 2025

Gjatë muajit dhjetor, nuk është raportuar asnjë epidemi.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok, komuna këto që gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, dhjetor 2025

KOMUNA	KOPJE FIZIKE									SMSN												
	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	OKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	
DEÇAN							197	37		234								85				85
DRAGASH							115			115								5				5
DRENAS							119			119								107	3			110
F. KOSOVË								29		29								197	79	168		444
FERIZAJ	11					271	61	260		603					8			14	7			29
GJAKOVË	1									1	23				34			279	170			506
GJILAN	0					297	95	579		971	12						27	101				140
GRAÇANICË										0												0
ILIELEZIT							120			120								9				9
ISTOG							75	90		165								64				64
JUNIK							16			16								26				26
KACANIK							93			93								1				1
KAMENICË						203	374			577								85				85
KLINË							245			245					1			3				4
KLLOKOT										0												0
LEPOSAVIQ										0												0
LIPJAN										0								37	1	34		72
MALISHEVË										0								120	1			121
MAMUSHË							128			128								105				105
MITROVICË	84		517	19			1150	658	20	2448								100				100
MITROVICË V.										0												0
N. BËRDË							48			48								5				5
OBLIQ							27			27								184	63	17		264
PARTESH										0												0
PEJË	39					2	303	946	165	1455	129							101				230
PODULJEVË							221	9	5	235								65	17			82
PRISHTINË		164	610				221	3254	791	5040		25	23			22	3	16	1163	11		1263
PRIZREN	46	85				31	756	563	48	1529		55						52	111			218
RAHOVEC										0					15				369	22		406
RANILLUG										0												0
SHTËRPCE										0												0
SHTIME							172	399		571								115				115
SKËNDERAJ							82	99	10	191								34				34
SUHAREKË						93	408	442	75	1018								153	5			158
VITI						91	161			252								36	37			73
VUSHITRRI										0	30							24	154			208
Z. POTOK										0												0
ZVEÇAN										0												0
Gjithsej	181	249	1127	19	0	1036	5139	7365	1114	16230	194	80	23	0	0	80	3	2049	2281	252		4962


Gjatë muajit dhjetor 2025, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) janë raportuar gjithsej 4,962 raste me sëmundje ngjitëse dhe krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve të raportuara (21,192) i shprehur në përqindje (23.4%). Gjatë muajit dhjetor 2025 vërehet një tendencë në rritje prej 2.3% e numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN krahasuar me muajin paraprak. (Tabela 4).

6. COVID-19

Gjatë muajit dhjetor 2025, në nivel vendi janë testuar gjithsej 762 mostra të dyshimta për COVID-19. Nga këto mostra, është konfirmuar 1 rast pozitiv me SARS-CoV-2, duke rezultuar me një shkallë pozitiviteti prej 0.13%. Rasti i konfirmuar i përket gjinisë mashkullore, grupmoshës 60–69 vjeç, nga komuna e Prishtinës, dhe nuk ka qenë i hospitalizuar. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me COVID-19.

Në krahasim me muajin dhjetor 2024, si dhe me muajt paraprakë të vitit 2025, vërehet një rënie e theksuar e numrit të rasteve, duke reflektuar një situatë epidemiologjike të qëndrueshme dhe qarkullim shumë të ulët të SARS-CoV-2 në komunitet.

(Graf 1)



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, DHJETOR 2025

MPOX

Gjatë periudhës 2022–2025, në vendet e BE/ZEE, Ballkanin Perëndimor dhe Turqi është raportuar qarkullim i vazhdueshëm i Mpox, me theks të veçantë në rastet e kladës I. Që nga gushti 2024 dhe deri më 17 dhjetor 2025, janë raportuar 64 raste të mpox klada I në BE/EEA përmes sistemit të mbikëqyrjes epidemiologjike TESSy, kryesisht të kladës Ib. Rastet janë evidentuar në disa shtete evropiane, me transmetim sekondar të konfirmuar në disa vende, kryesisht mes kontakteve të ngushta. Shtatë raste kanë kërkuar hospitalizime për trajtim. Një pjesë e konsiderueshme e rasteve janë raportuar te meshkuj që raportojnë marrëdhënie seksuale me meshkuj, me transmetim lokal të dokumentuar në disa vende. Rastet e kladës I te kjo grupmoshë tregojnë një model të ri transmetimi krahasuar me fazat e mëparshme të shpërthimit. Në total, që nga fillimi i shpërthimit, janë raportuar mbi 25 900 raste të konfirmuara të mpox në 29 vende të BE/ZEE, me disa vdekje të raportuara. Në Ballkanin Perëndimor janë raportuar raste të konfirmuara në disa shtete, ndërsa në Turqi janë raportuar 73 raste. Shumica e rasteve të tjera i përkasin kladës IIB dhe ruajnë të njëjtin profil epidemiologjik si më parë. Vlerësimi i ECDC tregon se rreziku nga klada Ib mbetet mesatar për meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj dhe i ulët për popullatën e përgjithshme. Përhapja e rasteve lidhet kryesisht me rrjete seksuale dhe me importime përmes udhëtimeve. Rekomandohet forcimi i mbikëqyrjes epidemiologjike, testimi, gjurmimit të kontakteve, vaksinimit parandalues dhe komunikimit të rrezikut.

Mbikëqyrja epidemiologjike e patogjenëve respiratore në BE

Gjatë muajit dhjetor, aktiviteti i infeksioneve respiratore mbetet i rritur dhe mbi nivelet bazë për këtë sezon, në shumicën e vendeve raportuese. Normat e sëmundjes së ngjashme me gripin dhe të infeksioneve akute respiratore janë mbi pragun bazë në pjesën më të madhe të vendeve, duke reflektuar intensifikim të qarkullimit viral në nivel rajonal. Të gjithë treguesit e aktivitetit të Influcencës vijojnë të rriten, me rritje të intensitetit, detektimeve laboratorike dhe pozitivitetit, ndërsa pozitiviteti më i lartë vërehet tek fëmijët e grupmoshës 5–14 vjeç. Paralelisht, hospitalizimet për Influcencë janë në rritje, me barrën më të madhe tek personat mbi 65 vjeç. Influenca e tipit A(H3) mbetet virusi dominues në qarkullim, si në mbikëqyrjen sentinel të kujdesit parësor ashtu edhe në atë spitalore, duke konfirmuar një sezon të dominuar nga ky nën-tip, megjithëse qarkullojnë edhe viruse A(H1)pdm09 në përqindje më të ulët. Në të kundërt, treguesit rajonalë të aktivitetit të SARS-CoV-2 vazhdojnë të bien dhe pozitiviteti mbetet i ulët krahasuar me Influcencën, si në mbikëqyrjen sentinel ashtu edhe në rastet e infeksioneve respiratore akute të rënda. Qarkullimi i RSV-së po rritet gradualisht në nivel rajonal, kryesisht tek fëmijët nën moshën 5 vjeç, por aktualisht në nivele më të ulëta se ato të Influcencës. Të dhënat nga mbikëqyrja e SARI tregojnë rritje të pozitivitetit për Influcencën, ndërsa hospitalizimet dhe në kujdes intensiv janë raportuar në rritje vetëm në një numër të kufizuar vendesh. Vdekshmëria nga COVID-19 dhe vdekshmëria nga të gjitha shkaqet mbeten në nivele të pritshme për këtë periudhë, pa sinjale të tejkalimit të normave historike. Karakterizimi virologjik konfirmon dominimin e vazhdueshëm të Influcencës A(H3), me disa klade në qarkullim, si dhe praninë më të kufizuar të viruseve A(H1)pdm09 dhe të Influcencës B/Victoria. Për sezonin 2025/2026, rekomandimet e OBSH-së për përbërjen e vaksinës trivalente reflektojnë këtë situatë virologjike. Sa i përket SARS-CoV-2, varianti XFG mbetet linja mbizotëruese e raportuar në Evropë. Në tërësi, situata epidemiologjike në rajon karakterizohet nga një sezon i intensifikuar i Influcencës, me ndikim më të theksuar tek fëmijët dhe të moshuarit, ndërkohë që aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët dhe nën kontroll, dhe RSV po rritet gradualisht pa arritur nivele alarmante.

Lepra – Rumani

Më 11 dhjetor 2025, Ministria e Shëndetësisë e Rumanisë raportoi një rast të konfirmuar dhe tre raste të dyshuara të leprës në Cluj-Napoca. Rastet janë femra me origjinë nga Azia, të punësuara si masazhere në një qendër spa. Fillimi i simptomave për dy pacientë është raportuar më 26 nëntor 2025, ku një rast u konfirmua përmes mikroskopisë pozitive për bacile acidorezistente. Testimi gjenetik GeneXpert MTB/Rif ULTRA rezultoi negativ për Mycobacterium tuberculosis, duke përjashtuar tuberkulozin. Hetimet laboratorike të mëtejshme janë në vazhdim. Autoritetet shëndetësore ndërmorën masa të menjëhershme, përfshirë pezullimin e aktivitetit të salonit, dezinfektimin e ambienteve dhe kontrollin mjekësor të punonjësve. Lepra karakterizohet nga transmetim i ulët dhe periudhë e gjatë inkubacioni. Rasti i fundit i leprës në Rumani ishte raportuar në vitin 1981. Sipas udhëzimeve të OBSH-së, rreziku i përhapjes së mëtejshme në popullatë vlerësohet si shumë i ulët. Impakti në nivel popullate vlerësohet gjithashtu shumë i ulët. Me zbatimin e masave të duhura të gjurmimit të kontakteve, rreziku i përgjithshëm mbetet shumë i ulët. ECDC është në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet rumune dhe po e monitoron situatën përmes mbikëqyrjes epidemiologjike.

Marburg

Që nga 12 dhjetori 2025, në Etiopi është raportuar një rast shtesë i konfirmuar dhe një vdekje shtesë nga sëmundja e virusit Marburg. Që nga konfirmimi i shpërthimit më 14 nëntor 2025 dhe deri më 18 dhjetor 2025, janë raportuar gjithsej 17 raste të MVD, prej të cilave 14 të konfirmuara laboratorikisht dhe tre të mundshme. Janë raportuar gjithsej 12 vdekje, përfshirë edhe dy punonjës shëndetësorë, me shkallë vdekshmërie prej 64.3% të rastet e konfirmuara. Dy zona në dy rajone janë prekur, ku qyteti Jinka konsiderohet epiqendra e shpërthimit. Rastet kanë paraqitur simptoma si ethe të papritura, dhimbje muskulore, lodhje të rëndë, dhimbje koke, diarre, të vjella dhe gjakderdhje në fazat e vona. Deri më 18 dhjetor, pesë raste janë shëruar dhe asnjë pacient nuk është aktualisht në trajtim. Janë identifikuar 349 kontakte, nga të cilat mbi një e treta kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes epidemiologjike. Autoritetet kanë intensifikuar gjurmimin e kontakteve dhe kërkimin aktiv të rasteve në komunitet. Një studim vaksinor është iniciuar në zonat e prekura dhe janë vënë në përdorim trajtime me antitrupa monoklonalë. Vendet fqinje kanë rritur gatishmërinë për përballimin e rasteve të mundshme të importuara. Sipas vlerësimit të ECDC, rreziku për qytetarët e BE/ZEE në Etiopi mbetet i ulët. Po ashtu, rreziku i transmetimit të mëtejshëm në BE/ZEE në rast importimi vlerësohet shumë i ulët.

Chikungunya

Që nga përditësimi i fundit më 14 nëntor 2025 dhe deri më 12 dhjetor 2025, janë raportuar 26 818 raste të sëmundjes nga virusi Chikungunya në 12 shtete, përfshirë 83 vdekje. Numri i rasteve të raportuara në muajin nëntor ka shënuar ulje prej rreth 39% krahasuar me tetorin, ndërkohë që numri i vdekjeve ka shënuar rritje. Meksika ka raportuar për herë të parë raste të Chikungunya gjatë vitit 2025. Aktualisht, 14 shtete raportojnë shpërthime aktive të virusit Chikungunya, kryesisht në rajonet e Amerikave dhe Azisë. Në Amerikën Latine, numri më i lartë i rasteve është raportuar në Amerikën e Jugut, me Brazilin si vendin më të prekur. Në Azi, rastet vazhdojnë të raportohen kryesisht në Azinë Juglindore, me Indinë si vendin me barrën më të lartë të sëmundjes. Në Afrikë, është evidentuar rritje e rasteve krahasuar me vitin paraprak, veçanërisht në Afrikën Lindore. Në Evropë, raste të Chikungunya janë raportuar kryesisht në rajonet përtej territorit kontinental, si Réunion dhe Mayotte. Në total, gjatë vitit 2025 janë raportuar mbi 485 000 raste dhe 229 vdekje nga Chikungunya në nivel global. Krahasuar me vitin 2024, numri i rasteve globale ka shënuar rritje. Rreziku i transmetimit në Evropën kontinentale lidhet kryesisht me importimin e rasteve nga udhëtarë viremi dhe praninë e vektorëve kompetentë. ECDC vlerëson se monitorimi i vazhdueshëm, mbikëqyrja epidemiologjike dhe kontrolli i vektorëve mbeten thelbësorë për parandalimin e transmetimit autokton.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>

E-mail: QOE.IKSHP@rks-gov.net

Telefoni+38338 541432
